




### Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

### Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite




Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 18.3 herë.

+ 3,334,008 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**



**Pasuritë e Luajtshme**



**Pasuritë e Paluajtshme**



## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	13,703,226	14%
Të ardhura nga paga e familjarëve	6,419,157	7%
Të ardhura nga biznesi	22,334,400	24%
Të ardhura nga qeradhënia	11,223,831	12%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	29,763,754	31%
Të ardhura të tjera	11,556,567	12%
<b>Total</b>	<b>95,000,935</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**5 Me Probleme**

Kontrolli aritmetik dhe logjik i subjektit Fatmira Hajdari ka rezultuar me probleme për 5 vite të deklarimit të pasurisë, ku vlera e pajustificuar në total për këto vite është 12,507,743 lekë. Në deklaratat e pasurisë ka gabime të shumta materiale, kryesisht të tipit ku vlera e shënuar me shifra nuk përputhet me vlerën e vlerën e përshkruar me fjalë, duke krijuar shumë shpesh paqartësi mbi vlerën e aseteve/ të ardhurave apo shpenzimeve të kryera nga subjekti dhe familjarët e saj. Vlera e detyrimeve bankare gjatë periudhës deklaruese është e lartë dhe nuk ka të dhëna të qarta nëse këto detyrime lidhen me aktivitetin privat që ushtron djali apo janë përdorur për të financuar pasurinë familjare. Konkretisht bëhet fjalë për kredinë prej 19,000,000 lekë marrë në vitin 2007, ndërsa totali i kredive të marra ndër vite kap vlerën 30,064,290 lekë. Subjekti ka deklaruar në vitin 2016 një hua prej 10,000 euro, e cila vazhdon të jetë detyrim i pashlyer deri me datë 31.12.2017. Në vitin 2013, djali i subjektit ka lidhur një marrëveshje private, sipas së cilës në këmbim të truallit prej 890m2 do të ndërtohet një objekt 10 katesh- ku në përfundim të marrëveshjes dy palët përfitojnë nga 50% të objektit të ndërtuar. Në vitin 2016 subjekti deklaron që pjesa e tyre e investimit përfshin përveç truallit me sip. 433m2 edhe shumën 204,000 euro - pa dhënë detaje si janë kryer pagesat dhe gjatë së cilës periudhë.

